

*Taimas. Çefes.
Shkolla Normale
Elboen*

Vlera e njeriut nuk qëndron
në dijen, por në
vullnetin e fortë

HERBART.

Normalisti

Mbrendija

Problemi i Moskalimit.
Ndjenja Patriotike.
Principet e Shkollës.
Mësuesi do të jetë i mësuem.
Si u-binda që "shëmbëlla" ka fuqi të
madhe Edukative.
Një pyetje.
Provë Mësimi.
Provë Mësimi.
Këndimi ekspresiv dhe recitacioni.
Për një lëvizje mendore t' arësimtarëve.
Udhëtimet në këmbë.
Një Hartim.
Guximi Femnuer.
Penda dhe Parmenda.
Shënimet e Redaksisë.

Normalisti

E përkohëshme pedagogjike, letrare, shkencore
DEL NJI HERË NË MUAJ.

E botojnë nxënësit e Normales

Editor: Harilla Kuçuli '37.

Sekretar: Kol Lekaj '37.

Arkëtar: Jovan Gjerga '37.

Ndihmësit

Tajar Reovica '38.

Panajot Foto '38.

Koço Mosko '39.

Drejtimi

E përkohëshmja "NORMALISTI,

Shkolla Normale

Elbasan

Dorëshkrimet nuk kthehen.

Pajtimet:

Për mësues

Copa lek 1.25

Për gjithë vitin fr. ar. 1.50

Për nxënës

copa lek 1.

Për gjithë vitin fr. ar. 1.

NORMALISTI

E përkohëshme pedagogjike, letrare, shkencore
DEL NË FUND TË ÇDO MUAJI
E botojnë nxënësit e Normales.

VITI I VIII.

— DHETUER 1936 —

Nr. 1

Problemi i moskalimit

Në një konferencë, që John Dewey mbajti përpara arësimtarëve ca vjete të shkuara, tha se faji i moskalimit dhe i mosgradimit të nxënësve në shkollat fillore dhe të mesme është aq i math i sistemit edukatif dhe i mësuesve sa edhe i nxënësve. Edukata progressive e quan moskalimin e nxënësve, një nga problemet më serioze që shkollat kanë përpara tyre. Është pa dyshim një katastrofë e madhe hëm për individin hëm për shtetin kur mot për mot qindra nxënës flaken jashtë sepse s'kanë qenë të zotë të mbarojnë punën e caktuar nga shkolla e të fitojnë notat e duhura. Meqë është pra një nga problemet më me rëndësi në përparimin e edukatës, disa dijetar të mbëdhenj, dhe veçanërisht Dewey, Monroe, dhe Thorudike, e kanë studiuar dhe kanë vënë në praktikë në shkollat Amerikane disa principa themelore.

Pikë së pari, në shkollat progressive çdo nxënës konsiderohet dhe respektohet si një individ normal, qi është

plot potencialitet për një çvillim harmonik shpirtor e trupor. Dhe me përjashtimin e rrethanave të familjes, shkolla është mjeti më me rëndësi për këtë çvillim. Është detyra e shkollës ta quanij çdo nxënës si një amanet (trust) të vlefshëm që duhet të hetohet me tërë mjetet q'ajo ka në dispozitën e saj, e të gjejë mënyrën më të aftshme që munt të shërbejë atij në formimin e mendjes dhe të zakonëve. Por që të kryenj detyrën e naltë siç duhet, shkolla nevojitet seftë të dijë se çë material ka. Sa kohë që puna m'ëmadhe e shkollës meret me inteligjencën e nxënësve, inteligjenca e çdo nxënësi matet me kujdes. Për këtë qëllim janë përfektuar disa teste të inteligjencës, si "Stadford Binet Intelligence Test," "Thorndike's Standard Intelligence Test," dhe "Thorndike's Intelligence Group Testing." Me këtë mënyrë shkolla ka në zyrat e veta rekordia e inteligjencës të çdo nxënësi. Përfundimet e këtyre testeve radhiten në tri sërë, A, B, C. Në sërën A. vi-

hen tërë ata nxanës që kanë treguar një inteligjencë kuocienti 110 gjer më 130, dhe quhet grupi superior. (Këtu këtë ka nxanës edhe më lart se 30, po të tillë themi janë fare të paktë). Në sërën B. radhiten tërë ata që zotërojnë një inteligjencë kuocienti 90-110, dhe quhet grupi normal. Në sërën C. vihen ata me 80-90, dhe konsiderohet si grupi mediokrë. Nxënësit që tregojnë një inteligjencë kuocienti nën 80 i quajmë anormale dhe i dërgojnë në klinikë psikologjike për invertigim më të thellë.

Tani vjen qëllimi praktik i këtyre testave. Duke ditur m'anën e inteligjencës se gjeri ku munt ta hedhë çapin një nxënës në fushën e mësimt, shkolla është në pozitë të këshillojë çdo student individualisht se sa lart ay munt të harrijë në studimet e tij. Por këto këshilla nuk bëhen difinitivisht, se ka qëlluar që një njeri me inteligjencë mediokre ka harritur në studime të larta m'anën e vullnetit të fortë. Veç kësaj, më parë se të këshillohet një nxënës, se ç'degë munt të vazhdojë me sukses, të tjera hetime individuale bëhen. Teste që provojnë interesin, abilitetin, dhe kapabilitetin e një nxanësi në degët e ndryshme, si literaturë, punë dorë, shkencë, gjuhë, matematikë, u janë dhënë nxanësve pas provës së inteligjencës. Gjith ashtu, rrethanat familiare, shoqërore, dhe financiale vëzhgohen me verejtje prej profesorëve të posaçëm për këto punra dhe rekordohen. Kështu që kur Drejtori bisedon për të pritmen e një nxënësi dhe jep këshillat etij, të cilat këshilla bëhen

me rezervë të madhe, ay bazohet në fakte.

Resultatet e testave pastaj përdoren për ndarjen e grupeve dhe të klaseve. Grupet munt të formohen me dy mënyra. Mënyra e parë dhe më praktike në shtetet fukarenj, ku methodat pedagogjike ecijn me hapa të vogla, është formimi e grupeve heterogjene. Kur maun, fjala vjen, tërë anëtarët e reshtit gjashtë, dhe formomë klasë, kjo klasë është heterogjene se këtu përfaqësohen tërë inteligjencat, superiore, normale, mediokre, dhe nga një herë dhe anormale. Kur bashkohen tërë këto abilitete në një resht, s'ka as pak dyshim se përfundimet janë të dëmshme. Duke mos ditur se ç'material ka, mësuesi ose profesori s'është në gjendje ti përgatitin mësimet me një mënyrë që tërë klasa të përfitojë sa më mirë që të jetë e mundur. Dëndur qëllon që mësimet janë mjaft të rënda dhe të përshtatshme vetëm për ata me inteligjencë superiore. Me që lënda e kapër Xen abilitetin natyral të tyre, në këtë rast normalët dhe mediokrët humbasin kohën më kot. Nga ana tjetër, në qoftë se lënda është e lehtë, të dy grupet e fundit përfitojnë, por grupi i parë fare pakë. Në një shkollë pra ku ka mjaft nxënës grupet heterogjene duhet të mos eksistojnë.

Mënyra e dytë është formimi i grupeve homogjene. Në këtë grup nxënësit radhiten si pas inteligjencës, rekordet shkollore, dhe nga njëherë dhe interesi. Për shëmbëll, në reshtin e pestë kemi dy paralele. Që të bëhen këto të dy klasat sa të jetë e

mundur të njëshme, duhen të merren parasysh hem inteligjencia e çdo nxënësi hem zotësia që ai ka treguar në shkollë vitet e kaluara. Kur formohet një grup i tillë, mësuesi është në pozitë të ketë dije për mbi kalitetin e materialit me të cilën ai do të punojë. Dhe sa më mirë që ai ta njohë këtë material, aq më mirë do të veprojë në paratitjen, paraqitjen, dhe çvillimin e lëndës të degës së tij. Ky tani detyrohet të verë re abilitetin natyral të klasës së tij.

Por me të formuarit në grupe homogjene nuk do të thotë se mos-kalimi e mos-gradimit do të eliminohen. Ka edhe shumë shkaqe të tjera që sjellin ngatëresa: Mësuesi është krejt i justifikuar të ndalojë kalimin e një nxënësi në qoftë se ai është i siguarur se nxënësi e kuptoi lëndën dhe kish mjaft abilitet ta assimilonte po të kish punuar si një Trojan. Pastaj vijnë shëndeti, rethanat familiare, shoqërore, dhe financiale. Atje ku ka grindje në shtëpi, ku shoqërimi është miserable, dhe ku fëmija s'ngopen me bukë s'munt të ket progres edukativ. Në raste të tilla, mësuesi është njerëzisht i detyruar të glykojë mirë më parë se të deklaroj falimenton e një nxënësi. Dëndur qëllon që nxënësi të zotë prej natyre e me vullnet merren më qafë dhe jeta e tyre çkatërohet nga shkaqe që kanë qenë jashtë fuqisë së tyre. Fatmirësisht, në grupe të vegjël dhe

homogjene mësuesit munt të hetojnë hollësisht situatën e nxanësve, dhe të kqyrin ndryshimet individuale ma me drejtësi.

Shkaqet e fundit, dhe shkaqe ma me randësi në mos-kalimin e nxanësve, janë shkolla dhe mësuesi. Shpesh herë shkolla është vetë shkakëtare se nuk zoteron mjetet e duhura për të cilat nxanësit kanë interes dhe cilësi speciale. Është natyra e njeriut të mos mësojë gjëra të thata, abstrakte, dhe kërjt theorike; ai do ta shijojë mesimin atë çastë që e mer, dhe s'ka as pak dëshirë të studiojë subjekte që janë lark nevojës së përditshme, lark jetës, jashtë praktikës dhe eksperiencës së përditshme, me gjithë që këto subjekte munt të bëjnë premtime për të pritmen.

Sa për mësuesit, ata gjithëmonë kanë bërë gabime në notat që kanë dhënë, në mos kalimet që kanë shkaktur, dhe në gradimet që kanë aprovuar. Shumë shkaqe e shtërngojnë mësuesin të jetë i padrejt. Ca më me randësi janë: Mësuesi munt të jetë plot prejdisë dhe inate personale; ai munt të mos e ketë lëndën të përshtatshme për inteligjencën e disa nxënësve; ai munt të jetë një ekspert në degën e vet, por i pazoti ti shpjegojë, më një mënyrë që tu zbulojë dhe tu ndreq të metat. Kur se në mësim vetëm ajo lëndë ka vlefë mbi të cilën nxënësit reaktojnë, ai munt të ketë qojtur ata si automata detyre e të cilëve është të pregatitin mësimin e të heshtin. S'ka as pak dyshim se një mësues, që falimenton shumë nxanës, ve ma tepër në dyshim zotësinë dhe inteligjencën etij se sa ato të nxënësve.

Stefan Treska

Nuk munt t' i vihesh me gjithë shpirt një detyre veçse kur i di vlerën dhe e dashuron.

(ALFRED CROISSET)

Ndjenja patriotike.

Midis ndjenjave të shumta që ka njeriu, një nga më të interesatmet është ndjenja patriotike. Nën shtypjen e saj, duam shoqërinë kombëtare, vëndin ku kemi lindur, dhe dëshërojmë t'a shohim më të lulëzuar në kohën e ardhëshme.

Dashurija e atdheut sjell me vehte një sërë dashurirash të tjera: na fut në zëmër dhëmbshurin për bashk qytetarët t'onë, për racën t'onë, për gjuhën t'onë, për zakonet t'ona, për organizatën t'onë.

Patriotizimi nuk është një ndjenjë e krijuar prej modës, pa rrënjë natyrale. Qytetërimi s'bëri gjëkafsh tjetër veç se e idealizoj, e tërholloj, po nuk e nxoti në shesh, se pse ka ekzistuar gjithënjë dhe në popujt e prapambetur:

Indianët e Amerikës së Veriut e kislin aqë të fortë dashurin e atdheut sa sakrifkohëshin për tributën e tyre dhe për vëndin e tyre. Kjo ndjenjë i bënte trima të rrallë, burra të kurajshmë, sa, në kohë reziku, vdisnin burrërisht dhe me entuziasmë.

Si mbas Burckhardt-it, banorët e Arabisë tregojnë një interes të pashoqtë për pushtetin e tributës së tyre dhe për famën e saj i pranojnë çdo farë therorije për lulëzimin e saj. Kur u versulet armiku, ndizen prej patriotizimit, krenohen dhe, dyke hedhur shigjetat, theresin: " Ne jemi Aenezë ..."

Natyrisht njeriu lidhet mbas vëndit të lindjes, mbas mënyrës së jetuarit me të cilën është mësuar. Këtë pikë munt t'a zbulojmë me një shëmbëll të prekëshme: Në disa pyje që ndodhen pranë Aveyon-it, në Francë, u gjet një djal' i vogël. Ky e kishte kaluar të gjithë foshnjërin e tij në vetmi, pa u takur me njerzit. Me t'u zbuluar, u shpu në Paris. Pas pakë kohë, u nxuar jashtë Parisit, e shpunë në luginën e Montmorency-t; atje, posa pa kodrinat dhe pyjet, syri i mori një ndriçim gazmor,

zuri të lëviste më me gjallëri, u çqetësua, u gëzua dhe u mundua t'ikte. Sado që në Paris e kishin mbajtur mirë, sa do që ja kishin kënaqur të gjitha dëshirat, ky djal' i vogël e ndjente vehten të pakënaqur dhe përpiqej gjithënjë t'aratisej.

Kjo dashuri për vëndin lindor bëhet më fortë për ata që kanë prindër, far e fis dhe miq. Tek disa njerës zhvillohet për t'u çuditur, si ndonjë smundje e rezikshme që gjen truallin e përshatshmë. Një autor angles, Guppy, në librin e tij "The Salomon Islands", thotë se kur i shpinin banorët e nisivet Salomon në arkipelin Fidji ose në Queensland, për t'i vënë në punë bujqësore, një pjesë e tyre vdisnin në vapor prej nostalgjije.

Dhëmbshurija e atdheut nuk është rrënjosur vetëm në zëmërat e atyre që janë vendosur në tokën prindore, po edhe në nomadët të cilët hidhen her ketu her aty, si mbas nevojave të jetës. Këta të fundit nuk i shikojnë me një sy vëndet ku kalojnë; tërhiqen më shumë prej fushavet q'i zënë si të tyret. Si provë, munt të rëfejmë Nishinamët, një tributë nomadësh në Kaliforni, të cilët e kujtojnë me mall luginën, kodrinën ose rafshinën q'e quajnë si atdhen e tyre.

Faktorët që forcojnë njësinë kombëtare, gjuha, raca, organizata e përbashkët etj. e ndezin ndienjën patriotike; lidhin bashkatdhetarët midis tyre. Nga ndonjëherë shkakëtojnë një simpatih midis njezëvet që janë prej kombësije të ndryshme. Berberët, të cilët jetojnë në malet Atlas, ushqejnë një urrejtje të madhe për evropjanët, për çdo gjë që ka të bënjë me qytetërimin oksidental; po kur pjekin evropjanë që flasin gjuhën e tyre, zbuten dhe i vështrojnë me një sy të mbël.

Patriotizimi, si çdo ndjenjë tjetër, e çmon më shumë se sa vlen objektin e vet,

të cilit i detyron forcën, gjith ashtu i shton dhe cilësitë. Bashkë me dashurin e atdheut përzihet dhe dashuri e vet-vehtes. Përgjithësisht patrioti e zë kombin e tij më të mirë dhe më të lartë nga kombet e tjerë. Në këtë pikë s'ka përjashtim as në shoqërit' e prapambetura: Esqimotë besojnë se, në fillim të botës, Zoti u mundua të krijonte një njeri të përsosur; mirpo, në provën e parë, nuk ja arriti qëllimit; krijesa doli plot me të meta; Perëndija e hodhi dhe e quajti koblu-na, do më thënë njeri i bardhë. Në provën e dytë, bëri krijesën e përsosur dhe quajti in-nu do me thënë esqimo.

Indianët e Michiganc-it (Amerikë), që thirren Chippewas, kur dikush bën ndonjë marrëzi, përdorin një fjali që ka këtë kupë tim " i trashë nga mëndja si një i bardhë..

Kranz i, i cili ka shkruar një histori të Groenland es, na tregon këtë ngjarje: Një Groenlandes pa një burrë prej një koinbi të huaj; ky ishte i ndershëm, i butë dhe i përulet dhe ay tha "Eshtë, edukuar aqë miirë sa ne..

Besime dhe idera të tilla i gjejmë dhe në popujt, që kanë një qytetërim të moçmë. Kinëzët i mësojnë fëmijët të besojnë se

janë më të lartë nga popujt e tjerë. Në librat e tyre, sa herë që flasin për të huajt, do të shtojnë ndo një cilësor këndonjë: i quajnë të paditur, t' ashpër kokëfortë, të dobët, etj., me një fjalë, i marrin për më t' ulët nga vehtja e tyre. Për Konfiscius-in, Kina ishte mbretërija qëndrore m' e rëndësishme në këtë botë; përtej kufivet të saj nuk kishte veçse njerës të dobët dhe barbarë.

Sa për Izraelitët vëndi i tyre ishte "një vënd fort i mirë..", "ku rjedhin qumështi dhe mjalti..", "m' i bukur' i të gjithë vëndevet..", ku banon një popull i Shënjtë, i zgjedhur prej Zotit. Persët, Grekët, Romanët, çdo popull tjetër i vjetër ka pasur për vehten e tij idera madhështore.

Prej të gjitha këtyre që thamë munt të nxjerrim një përfundim: Kur dëgjojmë dokënt prej ndonjë populli t'ulët, të prapambetur, të mburret me vëndin e tij, me gjuhën e tij, me racën e tij, me zakonet kombëtare, le të mos habiteni Veprim'i tij, i shkakëtuat prej ndjenjës patriotike, është krejt i natyrshmë. Për cilindo, trashëgimi kombëtar, sido qofitë, ka një vlerë të rallë.

Fejzi Dika

Principet e shkollës.

Këtu më poshtë do të qekim principet themelore të shkollës së sotme.

Cilët janë këta principe themelore të shkollës ?

a) Shkolla shkath, drejton — pa e thym — vullnetin e nxënësit. Puna e shkollës është me disiplinuem energjit e jo me i shtypun, me zgjuem arsyen e jo frikën, me zhvilluem personalitetin e çdo fëmije e jo me i modeluem në një tip të njëformshëm. Njerëzit që ka me formue kjo janë të lirë e jo subjekte. Ideali i shkollës është gjithëmonë një nga aspektet e ideat shtetnuer.

b) " bën që të veprojë shpirti " është një nga maksimet themelore të shkollës.

Nuk është koha më kur nxënësi qëndronte përgjumësh e memec në mësimet e mësuësit; përkundrazi ai flet me gëzim e bashkëpunon me mësuësin e 'tij me aktivitet, me dijen e 'tij të natyrëshme. Kështu intelligenca e 'tij prifet, fiton fuqi e shkathtësi. Jo më verbalizma, jo më mësimet të grumbullueme me forcë: shpirti nuk është një enë, që duhet mbushun; ai është një fuqi e qenëjes s' onë dhe zhvillohet n' ushtrime.

c) Shkolla çmon që një qënëje njerëzore të formohet jo për së jashtmi, po për së mbrendëshmi, e, pa mohuem se në punë të edukacionit e të njohive ka një farë mekanizme, ajo hudh posht gjithë sistemet,

që maten me e bëmë nxënësin një automat.

Shkolla nuk ndreq, por rrit. E pra e vetmja metodë qi i vjen ásht metoda liberale.

d) E hapët për të gjithë nxënësit, ep një mësim morali independent nga të gjithë doktrinát fetare, eksklusivisht të bazueme mbi eksperiencën e mbi arsýen. Me të drejtë i vjen keq që të mos preki nxënësit e familjet në ndjenjat e 'tyne fetare, por me gjith' atë ajo vezhgon me një kujdes të plotë me respektueme asnjánësin má absolute në pikpamje të konfesionit.

e) Shkolla nuk mëson për qejfe të tekave e të fantazis. Kjo ka disa rreglla themelore, të cilat ia ka diktueu psikologjija dhe eksperiencia, e prej këtyne kërkon aplikimin. Kërkon p sh. të ushtrojë ndijat e fëmijës, para se me i u-drejtueu inteligjencës së 'tij, që të shkojë bashkë me 'të, prej të njoftunavet në të panjoftunat, prej të lehtavet në të vështirat, prej konkretit n' abstraktin. Porosit mësuësít-një lloj me një mëndje në këtë punë me Jean Jacques Rousseau-n — për mos me harrueme kurrë që ata kanë para 'tyne fëmijë e jo burra dhe ngul këmbë me ju folë atyne si fëmijë. Me të vërtetë mësimi duhet me qenë i përshtatun moshës dhe zhvillimit intelektual të fëmijvet; nevojisht ndjek një rrugë progresive.

f) Me mësuem pak ásht një nga rregllat esenciale të shkollës. Kjo nuk ep veç se një numër të kufizuem njohnis, por do që këto njohni, të zgjedhuna me kujdes, të çfaquna në mënyrë q' inteligjencat e njoma të munden me i asimilueu mirë, t' u

sigurojmë nxënësvet një dije praktike plotësisht të pasunueme me nevojat e ardhshme të tyne.

Me mësuem pak, por mirë ásht ideali i 'sajë.

g) Modeste, njkohësisht dhe ambicioze, do që mësimi i 'sajë, sado i ngushtë qoftë, të ketë një karakter edukativ. Tue mësuem nxënësit, po n' atë kohë ajo zhvillon dispozitat intelektuale të 'tyne : shpirtin vezhguës, kujtesën, gjykimin dhe arsýen. Qëllimi i 'sajë në këtë punë ásht, që tue i bëmë nxënësit me dashun shkencat, të mundin me vijuem ata vet me u-mësuem má vonë. Ajo u bën një shërbim të paçmueshëm. I armatos me mjete të vjeshme pune, me ndihmën e të cilave do të mundin, në të ardhëshmen, me forcueu, me kompletueu, ose me rindertueu në nevojë një dijë shpesh herë superficiale e gati me u-fikë. " Në të gjithë njohnit ka asish që vdesin, asish që duhet të vdesin tue rënë në harrim, edhe ka gjithashtu asish që nuk dijnë vdesin. Ato që vdesin janë format materjale të dijës, e ato që nuk vdesin, janë shprehít e observacionit, të gjykimit e f' arsyetimit, të depozitueu mbrenda në shpirtinat. Këto shprehí janë substanca e shpirtit, janë shpirti vet. Me i krijuem má të afërmes qenëje njerëzore atë që nuk vdes, vet substancën e shpirtit, shpirtin, duhet para së gjithash me punueme shkolla „ (1)

P ë r k t h i m

Al Myftiu '27.

(1) Leon Deres.

Të rritësh një fëmijë, d. m. th. ta formosh së brëndëshmi.

M^{me} NECKER DE SAUSSURE

Mësuesi do të jetë i mësuem.

Që mësuesi të jetë personifikationi i dijes, lypet të njohin shumë mirë atë të cilën do me u a mësueu të tjerve dhe mjetet ma të thjeshtat rrealizuese të qëllimit të caktuem. Prandej përgatitja më e shkëlqyeshmja e mjeshtoris së mësuesit t'ardhëshëm asht paisja me një dije të shndoshtë dhe të plotë të landës dhe të methudhës së mësimit

Pedagogjia nuk asht mënyra për të mësue atë që s'e di. Për të thanë një idë, duhet t'a kemi, duhet t'a kuptojmë na për t'u shfaqë mbasandej kjarë të tjerve; duhet landa e nevojshme të cilën do j'u a mësojmë te tjerve. Mësimi i vërtet nuk mud të jetë veçse mësimi i vet-vetes; pse kurr të flasim mbi një landë për të cilën s kemi kurrfarë njohunije të plot, s' do të kemi as tonin as lëvizjen as gjallnin; por ma tepër shpirti shqetsohet dhe mësimi vjen e bahet më i pëveprueshëm. Mësimi i moralit, i gjuhës, i shkencave i gjeografis edhe i historis asht i percipët dhe abstrakt kur mësuesi nuk di ma shumë se atë, që do t'u a thotë nxanësve. A thue shifet nevoja me dijtë aq shumë gjana për t'u a mësueu fëmijve të vegjël? Po çka u vijnë mësuesave t'adhëshm, kimija, gjuhët e gjalla, letersija të cilat u mësohen atyne e që ata vetë s' do t'u a mësojnë kurr? Asht gabim madje gabim i randë asht një mendim i till, i cil mund të jetë edhe i damshëm. Pse në qoftë se dijmë shumë duhet të thomi shumë. Po pat mësuesi njohuni të percipita dhe të shkurtat, ai nuk mund te jetë i thjesht. Mësuesi nuk ka nevojë qi të jetë një dijetar. nemos tjetër të ket një dije të shndosh dhe të hapët që të ia zbusi pakëz shpirtin; pra me qenë dijetar, dijetar në masën modeste që përmendën Mësuesi qi zotnon landen

e tij i shef më sëmirit mardhanjet e njohive që kanë në mes të tyne.

Puna qi ka randsinë ma të madhe në një shkollë fillore asht mësuesi e në mësuesin asht methudha. Çdo mjeshtër ka një methudhë; prandej edhe mësuesi ka methudhën e të të mësueimit. Me veprue methudhikisht do të thotë, me pasë një mendim drejtues dhe një plan mësimi; asht me i vënë dispozition, me i organizue dhe i hartue mendimet dhe veprimet; asht me kërkue mjetet ma të thjeshtat për ti çue në vend ma me siguri dhe shpejti qellimin e caktuem.

Sá ma elementári asht një mësim aq ma shumë duhet të jetë i cak'uem, i ushqyem me punë dhe me fytyra të gjalla; pse vetëm punët dhe fytyrat flasin në shpirtin e fëmij dhe nguliten ma letë në mendë të tyne.

Mbassi veprimi i mësimit asht një nga detyrët ma të natla me të cilat mund të ngarkohet një njeri, mësuesi, perveç cilësive te tjera, duhet të jetë i landës Prandej çfardo kuptimi i njëj anëshëm asht i gabuem. Kush don të shtij në veprim çka t'i bijn ndër mend ase me e bazue mësimin përmbi sofismat ditonore, jashtë me kefë njeri Kush nuk e ka fuqinë didaktike ma tepër se vullndetin e mirë e të fort, atëherë atij kemi me i kushtue një vend modest, me gjithse na dhimet mbasi ai vetë e ndien se tregon karakterin dallues të së perkundertës, se mudshmenija i rri mbrapa vullndetit, se me fjalë të tjera, qet ma pak fryt se sá deshron. E për në qoftë se në një mësues me personalitet asht zhvillue ma fort një anë ase një cilsí ma tepër se tjetra, kjo mund të barazohet së pakut nga dhantitë e perkundërta të njëj mësuesi tjetër.

Elbasan Dhëtor 1936.

Sh. Arra

Duke vërejtur . . .

Si u-binda që “shëmbëlla”, ka fuqi të madhe Edukative.

Shumë herë njeriu vëzhgon, por nuk di se ç'farë vëzhgon; vërejtjevet që bën, pa dashur, nuk di t'u japë një kuptim. Kjo ngjet mbassi na jemi të pashtjelluar në punë të dijes psikologjike dhe, si pasojë, nuk jemi të zot që “duke parë”, të bëjmë vëzhgime; nuk dijme se nën çdo lëvizje të njeriut — dhe veçanërisht të fëmijës — fshihet një fenomen psikik me burim dhe shkak më vehte. Do të ishim plotsisht të formuar në dijen psikologjike sikur të dinim të analizonim dhe të spjegonim të gjitha ngjarjet e jetës së njeriut.

Fatkeqësisht nuk ndodh kështu; na fort rrallë vëshgojmë, duke shikuar. Të shumtën e herës nuk jemi të zot të përqëndrojmë vëmendjen t'onë dhe të spjegojmë një fenomen me anën e vëshgimit. Në këte mënyrë ato që mësojmë nuk përfitojmë t'i nxjerrim nga jeta. Ja se ç' më takoi të dëgjoj një ditë një mëmë e tha djalin të saj “Agim eja këtu të keqen nëna, të të laj pak . . . Agimi ishte 6-7 vjeç, nxënës në klasën e parë të shkollës fillore. Së pari nuk deshi të shkonte. Mirpo nëna, me përkëdheljet e sajë bindëse, filloi ta lajë.

Si e pastroi mirë në duart, në kokë dhe në fytyrë, fëmija shikoi një herë me vërejtje duart dhe i tha nënës: — më laj edhe një herë duart me sapun — Përse? — pyeti nëna e habitur — Dua t'm'i bësh të bardha si të mësuësit — ia pret përnjëherësh fëmija. Kaqë që . . . Me gjithë mbresën e fortë, që më la gjesti i atij nxënësi të vogël, nuk i gjeta as një “burim” fjalës së 'tij.

Si kaloi shumë kohë mësova se njeriu është i pajosur prej natyre me fuqinë e imitimit. Këtë instinkt të imitimit më tepër se kushdo e ka fëmija. Ky shtyhet së

brëndëshmi gjithënjë të imitojë. Çdo gjë i lë një mbresë të fortë dhe ka prierjen ta imitojë qoftë ajo e mirë a e ligë. Për këtë këshillohet që mësuësi të jetë “shëmbëll”, e nxënësve për ato që predikon. Këtu e kishte burimin gjesti i atij nxënësi të vogël: duke marrë “shëmbëll”, nga mësuësi, i deshte duart të bardha si ay. Tani një veshgim „retrospektif“ i asaj ngjarje më kthjelloi kuptimin e njëj fenomeni psikologjik.

Po “shëmbëlla”, ka fuqi edukative shumë më të madhe se ajo që treguam më lart. “Shëmbëlla”, në të vepruar dhe në sjellje, moralisht, është më e fortë se sa një këshillë e predikuar njëqint herë resht. Këte nuk do të mendohem t'Jua provonj me arësytetime por me kallzimin e një ngjarje që kam vërejtur: Një ditë kisha dalë për të shëtitur. S'kisha ecur shumë kur më ranë syt në një pemë, nën të cilën pash 3-4 fëmijë të ulur këmbë-kryq; ishin nxënës shkolle. Kur më panë u-çqetësuan. Që të kënaq kureshtjen t'ime, u-afrova të shoh se ç'bënin; krejt i habitur vura re se luanin . . . bixhoz. U fola pakë dhe disi i qërtova. Zura t'i këshilloj duke u-treguar përfundimet e këqia të kumarit. Po predikonja mirësjelljen kur njeri nga ata (që, siç duket, nuk kishte luajtur) më tha: “Zotni të gjitha këto që na the na i ka përsëritur mësuësi në klasë shumë herë. Unë, pa humbur kohë, përfitova nga ky rast të theksoj edhe një herë këshillat e mja; dhe ika . . .

Pa disa ditësh takova në një rreth burrash, të shumtët e të cilëvevet qenë prindër fëmijësh. Në bisedim e sipër, ra fjala tek mësuësi. Kumarxhi i math — tha njeri — Me të vërtetë — i a priti tjetri — terë ditën në kafene e kam parë. Në çdo

SHANÉ

grumbull kumarxhinjsh nuk mungon mësuësi i ynë.

Kur dëgjova këto fjalë, pa dashur, më erdhi ndërmënd skena e fëmijve shkollarë, që i gjeta duke luajtur. Passi pata rastin ta shoh disa herë edhe vetë mësuësin në tymin e kafeneve duke luajtur bixhoz, thash me vehte: fëmijt s' paskan faj, kanë ndjekur "shëmbëllën", e mësuësit të 'tyre. Këtej thoshte njëmijë herë një këshillë, andej vepronte kundra asaj. Predikonte një gjë dhe bënte një tjetër. Do të kishte bërë mirë si kur t'u kishte thënë fëmijve: " bëni si Ju them unë, por jo si veprojnë unë ", si u-tha prifti katundarëvet, kur e ndaloi priftëreshën t' i japë këmishën lypësit.

Duhet të jemi dhe pak "konsequent" n' ato që themi. Po s' dhamë "shëmbëllën", e atyre që predikojmë, këshillat t' ona, pa dyshim, do të jenë fjalë në erë. "Shëmbëllë", ka një fuqi të çuditëshme edukative; pa këtë këshillat nuk vlejnë. " Shëmbëllë", dreiton çdo njeri dhe më tepër fëmijën. Verejtjet që tregova më kanë bindur plot-sisht për vlerën edukative të "shëmbëllës", dhe më kanë shtyrë t' i japë të drejtë atij t' huajt që ka thënë: **Il y a dans l' exemple une puissance qui surpasse toutes les autres; on redresse autrui en marchand droit.**

Harilla Kuçuli

Nji pyetje

Mësuesi ose ma mirë të themi edukatori në të zbatuemit e mjeshtëris së 'tij has mjaft pengime dhe shumë herë takon në problema pedagogjikë mjaft interesante, zgjidhja e të cilave nuk është aq e lehtë.

Do t' ishte mirë, më duket, sikur në të këtilla raste ai t' i shfaqte këto problema e t' i rifte mendimet e 'tij me shokë të afërt e të largët, gojarisht ose me shkrim, me anë të ndonji riviste ose organi t'jetër.

Unë po filloj në këte numur të "Normalistit", me nji pyetje që më duket sa interesante aqë edhe e rëndësishme për shkollën t'onë:

Ja problema:

Në fillim të vitit shkolluer nji mësuës u ep nxënësvet të rendit të V të këte themë hartimi për ta zhvillue: "Dita e parë e shkollës".

Ja nji hartim i nji nxënësi të këtij rendi, hartim tipik, që më ka lënë nji vrragë aqë të fellë, sa s'më harrohet kurrë:

Hartim

- 1) Ditn hon filloj shkolla
- 2) Vi shkoll burg shkolla
- 3) Atje gjej kalamajt
- 4) Dal prej shkolle shkoj shpi.

Ju ndoshta mund të mendoni se kjo sqenë, për të qa e për të qeshë, ka ngja në ndonji skaj të Shqipnis, ku nxënësit nuk kanë pasë rast të marrin mësim të rregullshëm Jo, jo, Zotni, por në nji qytet fort të madh të Shqipnis s'onë dhe jo para nji shekulli, por para dy vjetësh.

Pyes:

Cili është shkaku i nji hartimi të tillë? (e mos të harrojmë se shumica e rendit në fjalë ka shkruë kështu). Si mund ta binte n'udhë ky mësuës rendin e 'tij? (deri në nji farë pike) Dhe si duhet të bëhet hartimi (ose edhe mësimet e tjera që i ndihmojnë këtij), që të mos mbërrijmë në nji përfundim aq të dobët?

U lutem arsimtarvet shqiptarë të kenë mirësin me shkruë disa rrjeshta, ku të shfaqin mendimet e 'tyne mbi këte çeshtje dhe t'ia dërgojnë "Normalistit". Këtij mb'ânë t'jetër i lutem të botojë nji ose dy nga shkrimet që i gjenë më interesante dhe për të tjerat të na bájë nji statistikë mbi numurin e personavet për çdo faktor në punën e hartimit, të cilit ata i apin më rëndësi.

Kur di të pyesësh, di të mësossh.

Shpresoj se do të kenë mirësin me dërgue shkrieme jo vetëm mësuesit e mësueset, por edhe inspektorët, të cilët kanë pasë rast me pamë shum hartime e metoda të ndryshëme, si edhe profesorët e giuhës të shkollavet të mesme, për të cilët këjo çeshtje më duket se nuk është pa interes.

Këte për të mirën e arsimit t'onë. Të shpresojmë

S. Papanisto.

Provë mësimi dhanun në klasën e III të t' Ushtrimores.

Elbasan 23/XI/36

Landa : Mësim jete

Thema : Voji i ullinit

Mjete mësimi : Voji ullini me kalitetet e ndryshme; një gotë me ujë dhe disa kokra ullini.

Dispozisioni

1) Ngjyra, shija dhe cilësit e tjera të vojit.

2) Nga e nxjerrim vojin e ullinit.

3) Si fabrikohet.

4) Kalitetet e ndryshme të vojit dhe dhe dallimi midis tyre.

5) Përdorimi i vojit : për ushqim, për dritë, për fabrikimin e sapunit dhe për të lye maqinat.

6) U-tregohen nxanësve kalitetet e ndryshme të vojit, u-jepet disave për t' i shijuem, u-bàhet prova për me u-vërtetuem se voji është më i lehtë se uji.

Hyrja. Mësuesi u-tregon nxanësve një shishe, e cila ka mbrenda voj ullini, dhe i ban ata që të tregojnë se ç' farë ajo ka brenda. Ata do të thonë se ka voj ullini dhe kështu mësuesi u-tregon qëllimin e mësimi : Sot ne do të flasim për vojin e ullinit.

Paraqitja. Ç' farë ngjyre ka voji ? Nxanësit tue e pasë parasysh natyrisht kanë për ta treguem ngjyrën e tij. Shijonie vojin e ullinit dhe më diftoni se si ju duket.

Voji i ullinit është pak i shijshëm, si i neveritshëm. Mësuesi : Po ta zhyzim gjishtin në vojin e ullinit dhe mbasandaj ta qisim prapë, ç' farë ka për të mbetë në gjisht ? Nxanësi. (Përgjigjet me fjali të plotë) se ka për t' u-ngjitë voji. Mësuesi : Po ta mbamë gjishtin, që e kemi zhytë në voj, drejt ç' farë do të bajë voji ? Nx. do të rrëshqasë Mës. Po të zhyzim edhe gjishtin tjetër në ujë dhe ta qisim prapë, si do të na duken neve të dy gjishtat ? Nx. Njani gjisht q' e kishim zhytë në voj është më i ndritshëm. Mës. Pse ? Se pse voji është i shndritshëm. Mësuesi. Po të marrim një gotë ujë dhe mbrenda t' i hedhim voj dhe t' a përziejmë, ç' farë do të shofim ? (Në qoftë se nxanësit nuk e dinë, atëherë u-bàhet prova dhe ata kanë për ta pa se voji është më i lehtë se uji). Mësuesi derdh pak voj dhe pak ujë dhe i ban nxanësit që të tregojnë ndryshimin që panë në derdhje, se si voji derdhet më me ngadalë se uji dhe pa zhurmë. Mësuesi : Ku e vemë vojin ? Nx. Në për shishe, qype e enë të ndryshme. Pse ? Se pse derdhet. Cilat sende të tjera derdhen ? Nx. Uji, uthulla, vena, rakia. Si i quajmë ato sende që derdhen ? (Bàhen që të tregojnë se i quajmë langje). Ç' ka është pra voji ? një lang.

Bàhet një përsëritje e cilësive të vojit, tue i tregue nxanësit me fjalish të bukura e të mira dhe me konstrukcion falish të drejtë (se pse qëllimi i mësimi të jetës është, që të mësojnë fëmija bukur e mirë).

Mësuesi : Nga e nxjerrim vojin e ullinit ? Nga ullini. Kur ? Në dimën. Pse ? Se pse në dimën piqen ullinjët. Si i kuptojmë ne se janë pjekë ullinjët ? Se pse nxihen (U-tregohen disa kokra ullini).

Si e nxjerrim vojin ?

(Me qenë se Elbasani produkon voj ullini nxanësit do të kenë pa se si e nxjerrin dhe kështu dy ose tre, njani mbas tjetrit tregojnë mënyrën). Në rasë se ata s' e dinë u a tregon mësuesi shkurt e shpejt.

Mësuesi : Kush prej jush ka shkue

ndonjëherë me ble voji? Vetëm një çmim ka voji? Pse? Se pse njani është më i mirë dhe tjetri më i dobët. Si e kuptojmë neve? Nga ngjyra. Pse? Se voji i mirë ka ngjyrën e florinit, kurse ai i dobëti atë të blertë. Po më si e kuptojmë? Nga shija. (Në qoftë se këto nxënësit nuk i dijnë u a tregon mësuesi).

Për ç'ka na hynë në punë voji i ullinit? Për ushqim, për dritë, për sapun edhe për të lye maqinat, që të shkasin më mirë e të mos ndryshken. (Këto nxënësit i tregojnë të nxitun prej pyetjesh të vullitëshme nga ana e mësuesit).

Përmbledhja Bâhet përmbledhja e atyne që u folën gjatë mësimit, d. m. th. e atyne që janë shënue në dispozicion.

Ushtrimi Dramatizohet mësimi për t'u bërë më interesant.

Mësuesi çon dy nxënës, ku njani përfaqëson tregëtarin dhe tjetri blerësin e vojtit. Kështu blerësi përpiket me anën e shijes dhe të ngjyrës të dallojë kalitetet e ndryshme, dhe tregëtari u-cakton çmimet si mbas kalitetit.

Çohen disa nxënës të tjerë. Këtyre u mbyllën sytë dhe nxitën që të dallojnë ujën prej vojtit me anën e të prekunit edhe të shijes. Në këtë mënyrë ushtrohen sa u-mësuan për vojin

Irakli Kasneci '37.

Provë mësimi

Dhanun në kl. e IV të
t'ushtrimores Elbasan

Landa: Mësim Natyre

Tema: Qymyri i drunit

Mjete: Copa drujs (dushku e lisi)
copa qymyri të përgatitun mir dhe keq,
pluhun qymyri

Dispozicjoni:

- 1) Përgatitja e qymyrit,
- 2) Veçorit e qymyrit.
- 3) Përdorimi i qymyrit.
- 4) Karboni dhe damet — Masat që

duhen marrë.

Shënimi

Hyrje Mbassi mësimi më i afërm ka qenë: drujt e pa frytshme të pyellit. Hyrja e këtij mësimi bahet në këtë mënyrë: Kush do ti kallzoi mësuesit disa nga druajt e pyellit: Nx. ahu, vidhi shkoza, lisi, dushku etj. Përse i përdorin kat. gjithë këto dru? (Nx. për t'i shitë e për t'i bamë qymyr.

Paraqitja 1) Paragatitja e qymyrit - Kush ka pa prej jush se si bëhet qymyri? Tregohet prej disave që mund të kenë pamë ose ndingjuem. Pastaj për t'i u-ngulitë më mir u kallzohet dhe prej mësuesit një herë, por në bashk-punim me nxënësit. Për me e ba ma intuitif vizatohet tue folun prej mësuesit.

Ma para kat. presin drut (lisi e dushku) copa të gjata dhe i bien në vendin ku do të bahet qymyri. Me se i pret kat. drut? (Nx. me sapatë, naxhakë sharrë etj). Drut e preme i çojnë në vendin ku do bahet qymyri. Kat. në fillim bajn një gropë si nja 2 pëllambë të fellë dhe në mest të saj ngulin tre huj të gjatë. Drut e vogla i mbështesin prân hujvet tue i vumun pjerrtas. Pse i vem pjerrët copat e druvet? Nx. që t'afrohen dhe të ndizen ma shpejt. Mbassi t'i kemi vumun të gjitha copat e drunit stivë i mbulojmë sipër me një shtresë dheje të njomë 2-3 cm. trash tue i lanë vetëm dy brima për anësh e në fund të furrës. Pse e mbulojmë me dhë? Nx. turrën e druvet e mbulojmë me dhe që drut kur të digjen mos bahen hi. Mbassi të kenë përgatit turrën e druvet i apim zjarrin në një brimë të tretë që lihet apostafat për atë punë. Në mest të brimave tjera. Tregohet prej mësuesit në vizatim që ban ay vet. Kur i vë zjarrin furrës në fillim shifët se del një tym i zi, i cili pak nga pak kthjellohet e ma në funt kthjelloht fare. Këtu për me nxitë vet veprimin e nx. pyeten pse në fillim del tym i zi? Nx. Në fillim tymi del i zi pse drut s'jan ndezun mirë. Mës. Po pastaj pse kthjellohet? Nx. kthjellohet pse drut ndizen mirë.- Këtë gjë e kan vumë ré fëmmit edhe nëpër shtëpijat e tyre kur ndez

nana zjarrin. Mbasi të dali tymi fare i kthjellët katundari kupton se qymyri asht djegun mirë në qarkun e brimavet që ka pas lanë çelë dhe çel dy brima tjera; M. Kur i mbyllim keto dy brima? Nx. kur të dali tymi i kthjellët. Kështu veprohet deri sa të bahet e gjithë turra e druvet mbasandej i mbyll të gjitha brimate Mbas 4-5 dite, si të jetë ftofufurra, e çelin dhe e marrin qymyrin.

2) **Vecorit e qymyrit** Qymyri që bahet si kur tham sipër qellon nga një herë që nuk digjet mirë. Tregohet prej nx. se qymyri që nuk asht pregatit mirë nuk 'ka nglyren të zezë asht i randë digjet me tym (tregohet një copë dhe kqyret mirë) kurse qymyri i pregatitun mirë asht i zi, i lehtë, digjet pa tym, asht edhe zanuer (tregohet një copë kqyret mir, kapet me dorë përplaset dhe nxjerr një zà të hollë). Kallzohet se thengjilli i drunit asht një pastrues i mirë. Në qoftë se hudhim plu hun qymyri në një lang që përmban erë të keqe, kjo erë hum se thengjilli i drunit thith gazin me anën e poreve që ka. Në për katunde që 'kan ujin e trubull të burimit e shkojn sipër një shtrese qymyri i cili thith dhe përmba gjith llucin e ujit. Pluhri qymyrit përdoret dhe për të lamun dhambët.

Perdorimi i qymyrit. Përse e përdorim Qymyrin? nx. Qymyrin e përdorim për t'u ngrohë dhe për hekur. Ku e ndezim Qymyrin? Qymyrin e ndezim në për tagare ose në koftor n'oxhak. Kur asht qymyri i pa ndezun mir nxjerr sipër njëflak jeshile që quhet karbon. Karboni asht një gas i helmët. Në qoftë se shliem tagar me qymyr të pa ndezun mirë në një dhomë të mbylle ahere njerzit

që ndodhen në të ka me i zanë qymyri.

Të zanunit e qymyrit e masat që duhen marrë Cilin prej jush ka zanë qymyri? kallzojn nx. pyetet se çka ndigjonte ai atëhere (nx.)

Tregohet se kur na zë qymyri ahere ndigjojmë dhambje koke edhe të përzieme. Në kete kohë njerzit e zanun prej qymyrit duhet ulun në ndo një vend të ftohët (çimento ose hekur) duhet lagun me ujë të ftohët në qoftë në krye në kambë ase në duer. Në qoftë se të zanunit asht shumë i fortë ahere i duhet marrë gjak në rranzët veshit, në qoftë se aty nuk gjindet mjek.

Përmbledhja

1) Pregatitja e qymyrit

- a) veglat presëse
- b) Lloj i drunit
- e) Të bamit e gropës.
- d) Të ngulunit e hujve
- e) Të vumit e copavet drunit
- S) Të mbulueimit
- g) Mënyra e të djegunit

2) Vecorit e qymyrit

- a) Dallimi i qymyrit të preg. mirë
- b) " " " keq
- c) Qymyri asht një pastrues
- l) hek erën e langjeve
- ll) kullues uji
- lll) Pastrues dhambësh

3) Përdorimi i qymyrit

- a) Për t'u ngrohë
- b) Për hekur

4) Të zanunit e qymyrit e masat që duhen marrë

- a) karboni
- b) shëjat e njeriut të zanun.
- c) masat

Sami Lamçe '37.

Arsimi fillor rreh të jetë një kohë edhe i dobishëm dhe edukuer, të bëjë gati fëmijën për jetën dhe t' i lëvrojë shpirtin.

Këndimi ekspresiv dhe recitacioni.

J.H.H.E.

Përgjigjen që duhesh t'ia jepja unë Z. H. Ballshi, për artikujt që kishte shkruar në Normalistin Nr. 4, vit' i V; Nr. 5, vit' i VII i a dha, terdhorazi, shumë mirë e më mirë nga unë, Z. S. Paparisto me artikullin e 'tij magjistrat e plot kulturë * Prej diallogut të V. Nastos me inspektorin e 'tij »

Mua tashti më mbeti radha të flas gjër' e gjatë mbi këndimin * ekspresiv „që kisha për mendur, sintetikisht, midis të tjerave, n artikullin t'im te Normalisti Nr 2 3, vit' i V, artikull. i cili e alarmojti shumë Z. Ballshi.

Pata shkruar, pra, në numrin e lartë për mendur te Normalistit „... se drejtimet e ra pedagogjike kërkojnë ta çlirojnë shkollën nga këndimi mekanik e i shpejtë dhe, në vënd te 'tyre, te vënë këndimin ekspresiv, si më i përshtatshëm e më teknik ».

Po ç'vlerë edukative ka këndimi ekspresiv dhe pse është më i përshtatshëm e me teknik ?

Këndimi ekspresiv është më i mirë e më i përshtatshëm për shkollën e solme, pse e udhëheq nxënësin në të kuptuar e në të ndierë të copës që lëçit.

Është më teknik ky farë këndimi, pse kërkon një puntë të persosur didaktike, duke afruar copën që lëçitet me zemrën e nxënësit që e lëçit. Kërkon një mësim intuitiv, të kuptuarshëm e interesant; kurse mekanizma e bën monoton e pa jetë këndimin veçitacionin e vjershave e të dialogave.

Çdo gjë që nuk kuptohet, nuk mund të lëçitet e të recitohet në mënyrë te kuptuarshme. Prandaj, mund të themi se këndimi ekspresiv dëftën shkallën e kulturës shpirtore t'atij që lëçit.

Kush lëçit mirë, shkruan mirë thotë një fjalë e urtë!

Kritiku Italtan F. De Santis, ne një

fragment biografik te 'tij, shkruan kështu: „... Kur thirresha te mirrnja pjesë, si antar, në ndonjë provim, zakonisht kerkoja nga nxënësi që po provohesh të lëçitte disa periudha dhe, për të dhënë gjykimin t'im, s'kisha nevojë për gjë t'jetër ».

Po si të bëjë Mësuesi që ta mësojë nxënësin t'i japë ngjyrë e jetë asaj që lëçit?

Që në klasën eparë të fillores te stervitet nxënësi t'i japë çdo fjale e fraze tonin, gjallërin dhe ekspesionin e duhur Gjithashtu në këtë klasë duhet mësuesi të ketë kujdes që nxënësit te mos marrin vesin e keq te kantilenës.

Që me klasën e parë të shkollës fillore, mësuesi duhet të ketë para sysh këto:

1. Per të lëçitur nxënësit ne mënyrë ekspresive, është nevoja e një këndimi të ngadalshëm që kështu te kenë kohë këta t'i shqiptojnë të gjitha rrokjet e prapash-timet.

2. Duhet ndryshuar zëri e përgjithërisht duhet ulur ky ne fjalet që mbarojnë me shënjat e piksimit dhe duhet ngritur zëri ne fjalvet që vijnë pas këtyre shënjave.

3. T'i jepet çdo fjale toni që i përket.

4. Kur lëçit nxënësi nuk duhet ta ndalim veçse në fund te radhës Kjo lypset te jetë si rregull për mësuesin.

5 Kur nxënësi këndon copën e caktuar mësuesi të ketë kujdes që ajo të këndohet me kuptim e art; të kerkojë nga ky, që në të lëçitur të përdorë, si në të folur, mënyra të pershtatshme perjashtimi ndjenjash e afektesh.

T'u apim nxenësve të kuptojnë, një her' e mirë, se të lëçitur nuk do te thotë gjë tjetër, veç se folur me librë në dorë.

Një ushtrim i mirë është dhe ai që te mesohen nxenësit që të lëçitin, përveç shtypshkrimeve edhe dorëshkrimet, duke shkëmbyer në mes të tyre fletoret e harti-

mit e të diktimit.

Këndimi ekspresiv e recitacioni plotësojnë njëri tjetrin dhe që të dy ndihmojnë në formimin e ndërjegjes së nxënësve.

Një njëjt ndihmës për recitacionin është edhe këndimi diallogjik, icili zgjon interesin e ù jep gjallëri copave të këndimit.

Në të zgjedhur të vjershëve, monologeve e diallogeve duhet përdorur shumë art. Duhet shporur pjesët që përmbajnë gjëra tragjike, fantastike e pa kuptim Nxënësve t'onë lypset t'u vëmë përpara pjesë që përmbajnë personazhë të vertetë: që mendojnë, ndiejnë, veprojnë e që përfaqësojnë jetën e vërtetë.

Këndimi ekspresiv është edhe një mjet i vlefshëm për edukatën mendore; mjeti më i përshtatshëm për t'ushtruar të përsiaturit dhe vëmëndjen e nxënësve. Me anën e një këndimi të mirë ekspresiv mësuesi mund të nxjerrë, nga zemrat e nxënësve të tij çdo gjë të mirë, që është ngulur atje, për ta zhvilluar e edukuar ca më mirë. Veç ketyre,

ky farë këndimi ka një rëndësi të veçantë edhe për mësimin e gjuhës.

Kur nxënësi lëcit qartë e saktë, do ti dijë dhe ti rrjeshtojë në letrë, me syndaks, mendimet e tij.

Në qoftë se nxënësit kanë arrijtur të këndojnë mirë e me kuptim, atëherë u kemi dhënë në dorë çelsin e bibliotekave që të studiojnë vetë. Keta, me të dalë nga shkolla, do të vijojnë të lëcitin e të lëcitin mirë dhe kështu, jo vetëm do t'i bëjnë të tyre sa kanë mësuar në shkollë, por edhe do t'i zgjerojnë, do t'i thellojnë e do t'i asimillojnë.

Me anën e një këndimi të mirë, të këndimit ekspresiv, mësuesi gjën kohën t'i bëjë nxënësit të shijojnë bukurit e prozës e të poezisë dhe t'u shtjerë në zëmër atyre etjen për këndime të tjera, që kështu të pasurohen nga idetë, ndjenjat e për fytyrimet.

Nga të gjitha keto, pra, rrjedh që këndimi ekspresiv ka rëndësi të madhe edukative e shoqërore.

V. Nasto

Për një lëvizje mendore t' Arsimtarëve.

Ndonëse arsimit i ynë në kohët e fundit ka hedhur çape të sigurta drejt përparimit të vërtetë dhe gjithënjë me siguri po lartësohet, përsëri e mira e përsosmishë së kulturës kombëtare kërkon një **autokritkë**, prandaj të metat duhet t' i cysim shpesh herë, edhe or' e çast. Të bindur, pra, të përmirësimi, që sjell autokritika kombëtare, herë pas here në revistën korçare "**Bota e Re**", kemi folur mbi disa të meta kryesore arsimore: për labyrinthe myneane të ndërtesave shkollore, për mungesën e orëdivë e të mjeteve mësimore, për edukatën e shtrëmbër familjare, për këndimet ⁽¹⁾ e papërshtatëshme si fuqisë mendore ashtu

¹⁾ Për këtë vit shkollor këndimet e rendit të II e të III të u-përmirësuan.

edhe rrethit, ku banon nxënësi e . . . për-gjithësisht kemi kërkuar e po kërkojmë një drejtim pedagogjik shumë a pak — pos' qe e mundur fare — të mbështetur mb natyrën e mbi gjendjen t'onë shqiptare, d. m. th. duam më tepër — si në shkollë si në praktikë — një pedagogji me veshje shqiptare. Tani të vijojmë pak më tutje: Për një drejtim të tillë pedagogjik na duhet të përgatisim edhe mësionjës, që të mos jenë të ritur vetëm me teorira të pedagogjisë moderne, por edhe me njohni të plotë mbi gjendjen psikologjike shqiptare. mbi edukatën t'onë familjare, mbi gjendjen t'onë shoqërore e përgjithësisht mbi **jetën e imtë shqiptare**. Mirpo në të gatuarit e një mësionjësi' që ta njohë jetën shqiptare-

ashtu si duhet e të jetë në gjendje për t'i përshtatur methodhat pedagogjike natyrës e gjendjes shqiptare, duhet së pari edhe një lëvrim i parreshtur pedagogjik, d. m. th. duhet një **lëvizje mendore e pashtëruar mbi problemet arsimore . . . shqiptare**. Për këtë **lëvizje mendore e të pashtëruar** duhet thënë diçka, e kjo **diçkaje** hyn në përkthimet e në shkrimet pedagogjike, qofshin ato volume të tëra, qofshin edhe shkrime rivistash. Për fat të keq në punë shkrimesh pedagogjike origjinale, po ashtu edhe në përkëthime jemi po thaujse **fare shterpë**: Si dyke e kërkuar me qiri në këndim më të harruar të ndonjë gazete a riviste fort rallë gjen një rreshtim fjalësh, që duan të thonë diçka mbi arsimin t' onë, por . . . zëri i dobët i shkruesit tretet në lithargjinë mendore të shumicës.

Një herë — jo më tani! — ishte një rivistë pedagogjike, mandej rev. "Mësuesi, e më së fundi . . . " **Edukata e Ré** ", që janë përpjekur për të përhapur një kulturë arsimore, por pa marrë përpara sysh natyrën e gjendjen shqiptare; prandaj shtojmë se dikur ishin disa revista pedagogjike, që përhapnin kulturë pedagogjike të . . . çalë për mësonjësin shqiptar! Mirpo tani edhe nga këto jemi larë dhe ron vetëm organi i nxënësve të Normales s' Elbasanit "**Normalisti**". Por lithargjia e jonë mendore përgjithëschet, ku mendon njeriu se i vetëmi kandil i rrugës s' onë arsimore — **Normalisti** — po neveritet, sepse shumica e arësimitarëve nuk bëjnë **kabull** (!!!) të shkruajnë në këtë revistë nxënësish, edhe pse disa të tjerë nuk e blejnë, se e ruajnë lekun e pajtimit për një mëngë fustani ase për ndonjë tavlo a domino kafeje!

Edhe në punë përkthimesh pedagogjike lithargjia mendore shtrin hijen e 'saj. Por . . . nuk mungojmë të çfaqim gëzimin se sinvijet — për mes shterpësisë së kaqë

viteve — u-botuan një a 3-4 veprëza pedagogjike: a — N. Kondili: "**Faqe të pedagogjisë moderne**", që është një punë e ngutëshme e auktorit; b — "**Një konferencë pedagogjike të Dr. Decroly-it**", që është një përkëthim i Sadi Pejanit i denjë për t' u-lëçitur; c — L. Fournel — "**Njohni të përgjithëshme pedagogjike**", një përkëthim i A. Rami-t dhe Kr. Vide-s shumë bukur i qëlluar për nevojat t' ona edhe d — "**Dr. Decroly**", që është një studim e një përmbledhje e goditur e S. Paparisto. (Mbi këto vepra shpresojmë të flasim në një numër tjetër të "Normalistit,")

E tani, dyke shikuar barometrin e botimeve shqipe, kemi: **origjinale = hiç; përkëthime = një a 3-4. = d. m. th. lëvizje botimesh pedagogjike = zero!**

E vërteta është e hidhur: Dyke shkruar vetëm nga shtëpia (a nga kafeneja) në shkollë, e nga shkolla në shtëpi (a në kafene), pa patur një rahje mendimesh, një ëçitje të vlerëshme, një studim të punës e një shkëkim të tejprerëshëm mbi punët arsimore praktike a teorike qofshin, pa këto shtojmë nuk kryhet puna ashtu si duhet. Prandaj arsimtarët, sidomos arsimtarët — që hyjnë në shpirtin e çdo familje shqiptare — duhet t' i përvishen punës mendore, të shkruajnë, gërmojnë, të çfaqin idë. Nga ëndërimi, që na ka përqendruar vetëm te pikat e programit e që na ka hutuar mëndjen aqë fort, duhet të zbrisim te realiteti dhe të nisim të veprojmë ashtu si na e lyp detyra. Për këtë na duhet edhe një rivistë pedagogjike, por jo rivistë skelet, jo rivistë e vdekur; na duhet një rivistë pedagogjike e gjallë, ku teoria e praktika të përputhen fare mirë, ku fryma e nxënësve evropjanë me frymën e nxënësve shqiptarë të analizohen hollësisht etj. etj. d. m. th. na duhet një rivistë **udhëheqës, rivistë pasqyrë, rivistë drite**. Hë për hë një gjë të tillë nuk

Herbert Spencer-i ka thënë:

Duhet të mësojmë sa është e mundur më pakë, por duhet të shtyjmë për të gjetur sa të jetë e mundur më shumë.

e kemi — më von mund ta kemi —; sot kemi vetëm një rivistë pedagogjike shkollore. Te kjo rivistë së pari duhet nisur puna mendore. Fundi, në qoftë se s' bëjmë **kabull** të bashkëpunojmë me revista nxënësish — natyrisht ky është një gabim shumë i math — atëhere le të rahim mendimet edhe nëpër gazetat e nëpër revistat e tjera; mjafton që të veprojmë, mjafton që të galiërojmë **lëvizjen e pashtëruar mendore mbi problemet arsimore shqip-tare.**

St. Spasse

Jean-Jacques Rousseau.

Udhëtimet në këmbë

Dij vetëm një mënyrë udhëtimi më të këndëshme se të shkuarit me kalë: t' ecurit këmbë.

Nisem kur të dua, ndalem si mbas qejfit, bëj aq shumë stërvitje sa të dua. Vërej gjithë vendin: kthehem djathtas, mëngjtas; vërej çdo gjë që më pëlqen; ndalem në të gjithë vendet, ku mund të shoh ndonji panaromë të bukur. Në qoftë se shoh ndonjë herë një lum, shkoj anës t' tij; një pyll të dendur, vete e rri nën hijen e t' tij; një shpellë, vete e vizitoj; një pus minesh, vete të vërej mineralet.

Kudo që më pëlqen atje rri dhe, porsa të mërzitem, shkoj. Nuk jam i varur as prej kuajve as prej karros; s' kam aspak nevojë të zgjieth një rrugë të mirë, kaloj në çdo vënd ku mund të kalojë njeriu; shoh çdo gjë që mund të shohë një njeri, dhe, duke qënë i varur vetëm prej vehtes t' ime, gëzoj gjithë lirinë që mund të gëzojë njeriu.

T' udhtosh këmbë, d m. th. t' udhtosh si Thalës-i, Platoni e Pythagora. Nuk mund të kuptoj se si një fillozof mund të vëndosë t' udhtojë ndryshe e të veçohet nga të vërejturit e begative që shkel me këmbë e që toka i paraqet me bollëk përpara syvet! Kush është ay që, duke dashur pak bujqësinë, nuk do të njohë prodhimet e veçanta në klimat e vëndeve që kapërren e mëny-

rën se si lavrohen ato? Kush është ay që, duke patur pak shijë për historinë e natyrës, mund të vëndosë të kalojë vokan në një fushë pa e vërejtur mirë e bukur; në një shkëmb pa dërmuar a thyer ndonjë copë të t' tij; në male pa mbledhur disa bimë për t' i studjuar; nëpër zalle pa kërkuar fosile?

Fillozofët t' uaj të mbyllur brenda studjojnë historinë e natyrës brenda nëpër salla a dhoma të veçanta e kanë grumbulluar aty sende të kota: ata dinë vetëm emra e nuk kanë asnjë ide të kthjelltë mbi natyrën. Por dhoma e Emilit është më e pasur se sa ajo e mbretërve: kjo dhomë është "toka e tërë". Çdo gjë aty është në vendin e saj: natyralisti që kujdeset për të, i ka radhur të gjitha gjërat në një regull të bukur; Daubenton-i⁽¹⁾ nuk do të vepronte më mirë.

Sa qejfe të ndryshëmë mbledhim në këtë mënyrë të këndëshme udhëtimi! pa numruar shëndetin që na forcohet, natyrën t' onë që gëzohet. Gjithënjë kam parë ata që udhëtojnë nëpër karro të mira e të rahatshme, endëronjës, të trishtuar, qertonjës ose vuajtës, dhe këmbësorët gjithënjë të gëzuar, të lehtë e të kënaqur nga çdo gjë. Sa na qesh zëmra kur i afrohem i shtëpis! Sa na duket i shijshëm një vakt i thjeshtë! Me ç' qejf ulemi në tryezët! Sa gjumë t' ëmbël bëjmë në një shtrat të keq!

Kur duam të shkojmë shpejt, mund të shkojmë kaluar, por kur duam t' udhëtojmë, duhet t' ecim këmbë.

E perktheu: Faruki Vrioni

(1) Daubenton, natyralist i famshëm, bashkëpunuesi i Buffon-it.

Hartime Nxënësish

Themi se Shqipja është e varfër; deri ku mund të jetë e drejtë kjo shprehje, e pse?

Shumë herë është thënë se gjuha e jonë është e varfër. Me qënë se thesari i gjuhës s' onë nuk është mbledhur edhe nuk

mund të themi me siguri se sa e varfër është gjuha shqipe. Me gjithë këtë mund të hedhim një veshtrim mbi 'të, për të shikuar se si ndodhet sot.

Gjuhën e qyteteve dhe të krahinave fushore e gjëjmë plot me konsrukte të huaja. Këto janë kryesisht Turqizme, Greqizme dhe Llatinizme. Qënia e kësaj sasi të madhe fjalësh e ka burimin në shkaqe Historiko-fetare. Me një anë padija dhe mos shvillimi i gjuhës, m'anë tjetër njësia e fesë me sunduesin e bënë shqiptarin të përvehtesojë këtë sasi të madhe fjalësh nga i huaji. Po nuk ngjet kështu në të gjitha vëndet. Malësit t'ona kanë fjalë që na nuk i njohim dhe të cilat janë origjine thjesht shqipe. Një pjesë e madhe e fjalorit gjëndet i pazbuluar në këta vënde, ku rallë shkeli këmba e të huajit.

Një gjë mund të thuhet me siguri: edhe kur të mblidhet dhe të pastrohet i gjithë thesari i gjuhës, shqipja do të jete pjesërisht e varfër: në fushën e diturive dhe të mardhënieve shoqërore Gjuha shjellohet paralelisht me evolucionin e kombit q'e flet. Të gjithë e dijme se fjalët i krijon populli; dhe populli krijon ato fjalë për të cilat ndjen nevojën. Populli shqiptar s'ka patur nevojën e termave shkencore se pse s'ka qënë pëparuar në dije; s'ka patur një shvillim mendor, prandaj edhe s'krijoi një kulturë të 'tij mu konstruete shqipe. Kjo rrymë filloi ti hyjë vonë në tokën arbrore; për këtë arsye vonë u-ndje nevoja e përdorimit të këtyre konstrueteve.

Populli i ynë, i robëruar për shumë kohë, s'pati edhe një qyteterim shqiptar. Errësira dhe padija, shkaktuar nga shtypja, pengoi çdo veprimtari qytetëronjëse. Në të gjitha fushat e jetës mbretëronte një pasivitet; ja edhe një shkak tjetër që nuk dha një shtytje shjellimit gjuhësor.

Nga pikpamje tjetra shqipja, me gjithë se e papunuar dhe lënda e saj e pagjetur, nuk duket kaqë e varfër sa duan ta paraqisin disa. Shumica e sinonimeve na tregon begatin e një gjuhe, sepse keto shërbejnë për të caktuar kuptime të veçanta Shqipja

ka një numer të math sinonimesh. Po t'i vërejmë këto fjalë do të shohim se, me anën e këtyre, mund të shprehim hollësisra gjuhësore.

Nga pikëpamja e frozeolegjisë gjuha e jonë s'është e varfër; e kanë provuar më te mirët e prozatorevet dhe poetet t'onë. Ndër shkrimet e këtyre shihet se sa bukur, me një frazeolegji shqipe, përshkruesngjarje dhe çfaqen ndjenja. Një vëzhgim në veprat e Fishtes dhe të Naimit do të na jipte te kuptojmë se sa fuqia e fjalës tek i par trubullon gjakun dhe tek i dyti prek zemren, zgjon ndjenja.

Per të dhënë fund, përsërisim se Fjalori i sotmë nuk mund të miret si bazë për të dhënë një mendim te prerë mbi begatin ose varfërin e Shqipes. Koha që kalojmë është periudha e kerkimit të lëndës gjuhësore. Numri i math i fjalëve të panjohura shqipe, që mot për mot mblidhën, tregon se fjalori i ynë do te jetë shumë m'i math se sa është sot.

Me kalimin e kohës, si të mblidhet i tërë thesari gjuhësor, s'është aspak çudi që të na dali Shqipja, jo aqë e varfër sa e kujtojmë, por, në disa pikpamje mjaft e begatësme.

H. K.

Guximi femnuer.

Friga është aq poshtnuese për gratë sa edhe për burrat; guximi është një detyrë për ata, sikurse dhe për në, për dy shkaqe të caktueme.

Pik së parit pse gratë kanë edhe më tepër nevojë se burrat. Pra, tue lënë n'anesh rreziqet e luftës të cilat janë i vetmi dallim, cila është shplaka, cila është vuetja, cili është rreziku qi nuk ju kërcnohet një lloj si në? Ato kanë të gjitha smundjet t'ona e, për më tepër, kanë edhe ato të vetat. Së fundit gëzimi më i madhi i një grues, të bamunit nënë, është për atë një mundim, një dhimbje e nga ndonji herë edhe shkak vdekjeje. Në rastë se një zjarm pëlset në shtë-

pinë t'onë, në rastë se një murtajë dheton qytetin, në rastë se një anmik pushton vendin, në rastë se një përmbytje prishë krahinën, a thue vallë gratë t'ona, vajzat t'ona, motrat t'ona nuk do të jenë viktima sikur na? A nuk kanë për ato ç'do ditë nevojë për mprojtje? Të ia u detyrojmë për guximin mbassi Zoti ja u kursen kaq pak vuejtjet.

Arsyeja e dytë, po aq e randsishme s'është para, është se në të vërtetë gratë janë aq të guximshme s'është dhe na Pá folë mbi mija rrethanash të veçanta në të cilat si nana, si bija, si nuse, si të veja, ose thjeshtësisht sikur grá, ato i japin burrave shembulla guximi privat; a nuk ká ndoshta raste në të cilat gratë japin prova guximi publik, në të cilat shfaqin një qindrim shpirtnuer në sherbimin e shtetit? E shka janë ato fetare, ato inferniere q'i rrijnë te kryet njeriut q'është tue vdekë o t'atijë të smuetit përveç se ushtarët e bamirsisë, të mëshirës dhe të therorizmës? A thua ndoshta nuk i aviten vdekjes për m'e përballue atë? Së fundit, gratë a nuk shkojnë nga ndonji herë si heroina ndër fushatat e luftës?— Gjatë luftës së Krimesë, një vajzë e re pasanike, Zonjusha Nightingale, u nis prej Anglitterre kú la familjen e vet dhe një jetë plot luks, për me shkue në mes të bombeve dhe të gjyleve me mbledhë të plagosunit mbi rrafshinat e Alms dhe t'Inkermaun-it.

Më 1870, gjatë rrethimit të Parizit, na kemi pá má tepër se një vajzë. má tepër se një Zojë tue rinjallë ndër rrugët t'ona të bombardueme shembullin e Zojushës

Nightingale. Mbas kësajë lufte të tmershme, mbledhja e Genevës vendosi q'edhe gratë të kenë një flamur: kryqin e kuq t'ambulancave. Për na mundemi me thanë me siguri q'ato në qoftë se nuk kanë guximin e një ushtari q'i vret, kanë një tjetër q'i me të vërtetë barazohet me atë: guximin ushtarak q'i shpëton.

Përkthim nga Italishteja

Xhabir Ismaili

V. D. V. '38.

1) Kjo pjesë është marrë nga Historija Morale e Gravet e E. Leganvé, romancier e pedagog Francez i shekullit të XIX.

Pênda e parmênda.

I

Mirë më shkruajnë përmbi letër
E peshojnë çdo fjalë veprë.
Unë kam gjuhë e nuk të rrëj:
Flas me njerës të mbëdhëj.
Gjuha 'ime flet për dije,
Ndan mendimet fije, fije.
Vetëm unë nuk di të flëj,
Të vërtetën sa ta gjëj.

II

Mos u-mburr kaqë fort, moj pëndë,
Se dhe unë jam një parmëndë.
Nuk e din se unë ngas arat?
Nuk e din se unë mbjell farat?
Nuk e din se unë tokën?
Nuk e din se unë mbaj botën?
Nuk e din se ti pa mue
Nuk do t'ishje sikur thue?

Qukapiku.

Shënimet e Redaksisë.

Bibliografi

Na kanë ardhur në zyrë:

•Dr. Drecroly, studim e përmbledhje nga bashkëpuntori i ynë Z. Sotiraq Papparisto. Çmimi lek 1.50.

Z. Papparisto, me këtë studim të vogël të Pedagogut Dr. Drecroly, na jep një ide mbi jetën dhe veprën edukative të këtij. Duke marrë parasysh mungesën e të për-

Mëson aq sa nxë. ai që nuk nxë dhe s'zhvillon vehten më, bëhet i pazoti te shtjellojë te tjerët.

(DIESTERWEG)

kohëshmevet pedagogjike dhe të teksteve gjithfarësh, në dobi të mësonjësit, e gjejmë shumë të vlefshëme broshurën e Z. Papanisto. Tek ne thuejse të gjithë pedagogët e kohës së sotme janë të panjohur. Kurse edhe emrat e tyre na duken "emra fshatash", siç thonë disa, si është e mundur të dijme sistemin e tyre edukativ?

Na nuk do themi e "përgëzojmë", Z. Papanisto, por do të themi e falënderojmë për shërbimin që na sjell edhe neve duke përfutur nga studimet e larta pedagogjike, që është duke ndjekur.

"Njoftime të përgjithëshme Pedagogjike,

Përkthim nga mësonjësit Abdulla Rami dhe Kristo Vide. Shtyp. "Atdheu, Vlorë. Çmimi lek 5.

Ja dy mësonjës që punojnë! Që t'i dalësh në krye një pune të tillë duhet të kesh vullnet, qëndresë, etje për studim. Arësimitarët K. Vide dhe A. Rami, me librin që përkthyen, i dhanë mësonjësit Shqiptar një mjet me tepër; i shtuan diçka jo të vlefshëme, por të nevojëshme bibliotekës së varfër të 'tij.

Përsa i përket përkthimit ne ua lëmë revistave të tjera profesionale për ta gjykuar; na vetëm gëzohemi që ka njerës, që viren punës, për të nxjerr ne dritë përkthime veprash të dobishme sikurse ajo e L. Fournel-it. Që vepra e L. Fournel-it është e dorës së parë në llojin e saj, s'ka dyshim; të përkohëshmet pedagogjike franceze ua rekomandojnë mësonjësvet të 'tyre. (Shihni "Journal des Instituteurs et des Institutrices", Nr. 40, Qershor 1936.)

Një hap përpara.

Më 25 të Nëntorit, nën nxitjen e Grupit drejtonjës të së përkohëshmes "Normalisti", dhe me vullnetin e gjithë nxënësve të Normales, u themelua një bibliotekë shkollore e cila u-pagëzua "Biblioteka Normalisti". Kjo do të jetë një bibliotekë për nxënësin dhe në duar të nxënësit. U vendos që kësaj bibliotekë t'i përpilo-

het një farë statut-regullore simbas të cilit do të veprohet, si të ketë marrë fund grumbullimi i librave.

Një bibliotekë e tillë u-pa e nevojshme nga nxënësit e shkollës s'onë, të cilët e bënë këtë "hap përpara", të bindur se do të krijojnë një mjet edukativ për vehten e 'tyre. U drejtuan thirrje të gjithë intelektualve dhe dashamirësve të "Normalistit". Bashkë me të përkohëshmen t'onë u dërgojmë thirrjen edhe graduatëve të shkollës s'onë, që gjenden në krahinat e ndryshme të Shqipërisë, me shpresë se do të na ndihmojnë, duke na dërguar një ose dy libra a revista, simbas dëshirës.

Fushata që hapëm këtu n'Elbasan pati sukses. U mblohdën një sasi e madhe librash nga dashamirësit t'anë dhe nga nxënësit. Premtime përkrahje na vijnë vashdimisht nga ata që s'kanë ndihmuar edhe. Ndër ata që na kanë përkrahur gjer më sot të poshtëshënuarit kanë ndihmuar më shumë dhe prandaj i falënderojmë nxehtësisht:

1. Z. Sefer Maliqi, pronar
2. Z. Ibrahim Kurani, libra shitës
3. Z. Thanas Konomi '24, nëpunës i

iprotekave.

4. Z. Qemal Bobrati, dentist.

Nga nxënësit ata që kanë dhënë më tepër libra si dhuratë "Bibliotekës Normalisti", janë:

1. Shefqet Kruja nxënës i klasës së IVtë
2. Elhami Nimani " " VItë
3. Xhafer Xyrxa " " VIII-të
4. Zenel Muço " " VIII-të
5. Irakli Kasneci " " VIII-të
6. Skënder Libohova " " II-të
7. Andrea Nasi " " VIII-të

Lëvizja Sportive

Lëvizja sportive, si në çdo vjet, filloi këto ditë e fundit. Ndër garat e ndryshme, që do të bëhen, është edhe kampjoni i footballit midis klasave të cili filloi. Kohëmbas kohe, në çdo numur të rivistës s'onë, do të shënojmë klasat që do të dalin të parat në garat kolektive dhe nxënësit që do të klasifikohen të parët në garat individuale

Një numër i math mësonjësisë të rinj filluan këto ditë nga detyra: janë Normalistët e '35ës. E përkohëshmjia e jonë iu uron sukses në jetën praktike.

“28 Nëntori, në shkollën t'onë

Sikurse është zakoni mbrëmjen e 27 Nëntorit u mbuluan në gjithë nxënësit në sallën e bukës. Mbledhjen e kryesonte Nën drejtori Z. Dr. Kamsi, i cili me këtë rast mbajti një ligjëratë të bukur.

“Për shumë mot na qoftë festa e sodshme, e cila na kujton ditën fatlu me, ku Shqiptarët kputën çengelat e robnis dhe muernë frymë të lirë; kështu e filloi ligjëratën Z. Kamsi.

Ai në mes të gëzimit na bëri dhe të mendohemi pakë: Z. Nëndrejtor në mes të tjerave tha se “I përmenduni plak Ismail Qemali tue ngritur flamurin t'onë, u la një porosi brezave t'ardhshëm tue thënë: Amanet po u la këtë flamur, të cilin duhet me e mbajtur me jetën t'uej, me e zbuluemeun me forcën t'uej aq fort sa me mujtur tanë populli Shqiptar në një liri të plotë me u çlodhë nën hijen e tij. —

Kjo është pra porosija qi trashiguem fatbardhësisht prej ditës 28 Nd. të vjetit 1912,.

“Për me zhdruk disa smundje të rrezikshme e me i çfarosë disa mikrobe që ja kanë helmueun gjakun popullit t'onë duhet me u rranjosë ndër zemra të dëlminis ideja Shqiptare, e cila karakterizohet nëpër tri cilsi na të shpirtit të vërtet Shqiptar: **b e s a, n d e r a e b u r r n i j a** këto e kanë bërë Shqiptarin luftëtar e hero e kanë qenë fortësia e pathyeshme për sulmimet e anmiqve t'onë.”

Pastaj Z. Nëndrejtori u drejtohet nxënësve me këto fjalë plot me kuptim:

“Me u bashkuar e me punuar për

kombin t'onë “Po mbahe mi me gjymshën e kafshatës së popullit t'onë të vorfën, m'u mundue me përmbledhë në vehten t'uej iden Shqiptare, të mjaftë e kështu të përgatitun me zdryp prej shkallës shkollore poshtë të Populli i uej e me i hymun thellë shpirtit t'atij, me ia ndi dhimbjet, vajtimet e ankimet.”

“Shkurt me thanë ju duhet kurdoherë me punuemeun bashkë me popull e gjithë për popull.”

Ma në fundë Z. Dr. Kamsi e mbyll fjalimin duke bërëtitur: “Rroftë e qoftë dëlminija Shqiptare dhe valotë anë e kand flamuri ynë për gjithmonë.”

—Pas ligjëratës u çftaq prej nxënësve farsa: “Dy zotni pa pantalona, — brohorira, të qeshura e shaka.

Pas farsës koncert. Koncerti, i përbërë prej një grupi Normalistësh dhe prej Z. Z. S. Popa e Kajanaku, u drejtua prej të mirënjohurit Z. B. Kongoli. Në koncert u lojtën shumë pjesë të bukura ndër to dhe, “solo” prej Z. Kongoli. Serenata e Schubertit, kaq e dëshëruar, u prit me duart trokitje prej nxënësve.

“Normalisti” falënderon Z. Kongoli me shokë.

Dita e 28 Nëntorit: Normalja paraqitet sivjet me diçka më tepër: një e katërta e batalionit të Normalistëve përbëhet prej vajzave Normaliste. Ato kënduan disa këngë të bukura me dy zëra përpara popullit që i duartrokiti. Kjo ngjarje, ndonëse duket pa rëndësi, ka kuptimin e saj.

Në mbrëmjen e 28 Nëntorit, bashkë me disa profesorë, nxënësit dalin me drita në dorë dhe shetitun nëpër rrugët më kryesore të qytetit duke kënduar e brohoritur. —Përpara bashkis u hoq një valle laçe.

Kënga popullore ia vishte më tepër rroben kombëtare festës dhe gazit.

Të hihte këngë e Labit: **moj Shqiponja me dy krerë kur do vemë në Prevezë.**

Më entusiastë duken nxënësit sivjet.

Ojtë shetitjeve nëpër rrugë na snotë qëroi dhe dashamirësi ynë ish-nëndrejtori Z. Prof. Vasil Andoni.

Fjalë të qëmtuara në rreth të Përmetitë me të kujdesurit të Zotit Pano S. Tase.

Alurina, halurina : gjagjëja, sende që kanë hala, si pishqët etj.

Arrakat (fem : arrakate) : kafshë kopeje (dele o dhijë) që nuk' shtrohet' në kullotë po ndahet' nga shoqetë; për shëm : Më ka ndezur' me nja dy dhij' arrakate.

Anavasënj : ndreqënj, vënj në vijë, vënj për vijë punënë; për shëm : Akëcili e e anavasi punënë (= e ndreqi punënë' që e kishte të ngatërruarë); U anavas dhe akëcili (= e hodhi luminë; e kapërxeu të ngushtën' në të cilën' pati rënë; gjeti atë që kërkonte; gjeti shpëtim)

Asposëm : shkrepem nga një gjë; mbetem pa 'të; për shëm : U asposëm nga buka simvjet (= hëngrëm shumë bukë simvjet); U asposa nga paratë (= prisha shumë të holla dhe kam mbetur' fifullë); Ky dimërë na asposi nga drutë (= na shkrepim nga drutë: nuk' na mbetën' drû).

Ashërë (— ra) copa, bujashka të mëdha kërcuri të çarë me sëpatë.

An' je (— ja) dhe jan' je (— ja) : faqe, napë për të mbuluarë një nim, një kanape; anëlë.

Avosem : (thohet' për njerës' gjumashë, për njerës' që flejnë shumë) trullosem, më rëndohet' kryet' nga gjumi; për sh : Sado flejte se uavose në gjumë.

Avosurë (i —) : i kapluarë, i rënduarë gjumitë; i ngritur' nga gjumi me kokë të rëndë.

Barkacel : njeri me bark të math; barkalec.

Bullçim (— mi) dhe bullçimë (— ma) : ana e brëndëshme e faqesë; bulçijë; vulijë.

Bllaçitem : mblaçitem; përtypënj, përtypem me plotë bullçiminë, me bulshijë plotë.

Bokërinë : tokë e hollë, e varfërë, që nuk' është pëllore; gorgolinë; krakurinë.

Bravare : kope e përzjerë e ndonjëj fshati që nuk' ka fuqijë të mbanjë shumë barijë; kope me bagëtitë shumë shënjash (shumë zotërash); p. sh : Kishja dy dhij' po i lëshova me bravaret' të fshatitë.

Beçka : breçka; brekë; pantallona.

Bujazhgë : bulazhgë; copë druje që këcen nga sëpata.

Byk (— ku; bykëra) : kashta e imëtë, e dërmuarë, e grirë; p. sh : Bykërat' i hanë më mirë kafshëtë

Brezarkë : peronë, gozhdë për të mbërthyerë brezat' që lidhin', që njëjeshin' muretë.

Bimcë : katqa, sdryme ndënë shtëpijë për verë etj.

Bunitem : ënjtem; buavitëm.

Buniturë : (i —) : i ënjturë, i buaviturë.

Burbuletëm : purbuletëm; hanj mish, gjalpë, qumështë, djathë etj. që prishin' agjërimin' për të krishterëtë; hanj gjellë të lyrëtë.

Buburiza dhe buburiza : drydhet' të gjalpit' që nisin' të dalin' mbi qumështin' e tundurë.

Borroçitem : përpiqem; rrihem; mundem; (thuhet' për dematë, po përdoret' edhe për njerëzishëm sidomos për të rinjë të fortë).

Bullundrisem : pullundrisem; nisem; stolisen; pispillosem.

Bullundrisurë (i — —) : i pullundrisurë; i nisurë; i stolisurë.

Brucë : gunë e zezë, pa mëngë, me flogje (me theka) si rreshda; sharkë; shark (— ku).

Bigaçe (— ja) : ç' do sent, drurit', hekurit' etj. që mbaron si bigë.

Brambullë : flakë e madhe zjarri; p. sh : Zjarri u ndes brambullë.

Brambullonj : (thuhet' për zjarrinë kur lëshon flakë të madhe, kur ndizet' me flakë të madhe); p. sh : Zjarri brambullonte an' e mb'anë.

Cfitnë (sidomos në shum. cfitna) : intrigë.

Cëmat (— ti) : thumat; pykë e vogëlë (hell i vogëlë) për të qepurë lëkura, thasë etj.

Cmat (— ti) si dhe cëmat.

Cmatosënj edhe cëmatosënj : qepënj opinga, rripa etj me cmatinë.

Cefëllë : cipale; bujashkë e imëtë.

Ceflosem : shkrihem (bjenjn) cefëla-cefëla.

Ceflosurë (i — —) : i shkirë (i dalurë) cefëla-cefëla; që bjen cefëla-cefëla.

Cftykë : copë e madhe buke; xërrëngë buke; p. sh : Erdhi bariu dhe mori cftykën' sa koka e tijë.

Cëmon (më — —) : ndjenj ku e ku (kur e kur) të dhëmbura si të picikuara, si të qukura që nuk' mbajën' gjatë; p. sh : Më cëmon dhëmbi (zemëra etj.)

Cingërimë : të ftohëtë të tepërë; të ftohëtë të pikëtë, që qethën, që piskon.

Cikëmë : si dhe cingërimë.

Cyly—cyly : fjalë të përkëdheluri për kalamanjë sidomos nga ana e nënavet', gjyshevet' etj. p. sh : Fëmija e tijë janë marur' cyly—cyly (= janë të përhedhur' nga të përkëdheluratë).

Çafkë : qeft, çaçkë, filxhan për kafe.

Çkalitar (fem. çkalitare) : i përkëdhelurë; i rriturë me të përkëdhelura; i mësuarë keqë nga lajkatimet' të të vehtëvetë; p. sh : E mirë është mblestëra e akëcililitë, po e thonë si pakë çkalitare.

Çkalitem : jam i përhedhurë nga përkëdhelijat' të tepëra.

Çekure (— ja) : ç' do vegël' e mprehëtë (sëpatë, thikë etj.) që i është mpihurë (topiturë) krejetë presa; p. sh : M'uprish sëpata m'ubë çekure.

Çepeluke (— ja) : vegëlë të prerë (thikë, sëpatë, drapërë, kostërë etj.) që nuk' pret mirë; p. sh : Kam një çepeluke—thikë (një çepeluke—kosë) që nuk' të hyn në punë.

Çokaninj dhe Çokanisënj : grinj mishë të holl' e imëtë për gjellë.

Çaplenj : shqyenjë; çapëllenj.

Çaplehem : çapëlohem; hapënj shalëtë tejë masësë; p. sh : Ngadale se uçapleve (se uçapëleve).

Çaplyerë (i —) : i hapur shalëtë pa masë.

Çepeke (— ja) : tufë flokësh e lënë mbi tutul të ballitë mbë të qethurë.

Çile — ja : arrë e plotë; arrë me thep (me bukë); p. sh : Kaçka çile.

Çikë (—ka): shkak; të ngarë; të ngacmuarë; p. sh: Ay më dha çikë; Mos i ep çikë.

Çoçkë (—ka): copë; grime; p. sh: Na ubënë dërrasatë çoçkë.

Çqoftua: i paudhi; i mallkuari; i qoftëlarguri; i përroitë; i lumitë; i panakarmi.

Drangullë sidomos në shumë: Drangulla: brenga; të çara kreji; kujdesa.

Dockë (—ka; dockatë): kalliri, koçumbeja e misërit' pas si t'i shkoqen' kokëratë; Dockat' të grira hyjën' në punë për ushqim të lopëve' në dimërë, po përdoren' dhe për të djegurë në vatërë, dhe si mbulesa për qelqe, për shtëmba etj.

Dorac: i zënë nga njëra o nga të dy duarëtë.

Dokoman: i trashë; i plotë; i mbushurë; i ngjallurë; p. sh: Sgiodhi një korrovesh (garravesh) rrushi sa një dokoman (=një vesh rrushi të plotë, të mbushurë).

Drasë: rasë guri për të mbuluar' shtëpijatë, në vënt të tjegullavetë.

Derëmyllëmë: burrë, grua që s'din të mbanjë rjegullë në shtëpijë o në punë të vehtë.

Damballa (e huajë; ndofta greq. dhiaplata): hapurë mbë të katëra; p. hh: Dyer' e dritore hapurë dhamballa.

Dhëmbarash: dhëmbërrallë; që ka dhëmbët' të rrall' o të shtrëmbëtë.

Dhirëtë (i—): i komëtë; i prej qime dijs, i prej dhije, p. sh: Gunë e dhirëtë (= e bërë prej komi).

Fërtelë (—la): copë; leckë; rripë; p. sh: Na ubënë rrobet' fërtela nëpër driza (nëpër shkarpa).

Flakërishta (shum.): shkarpa (kARTHJE) të thata për të bërë flakë.

Furkulicë: pirun; prokë.

Fshehurickë: fshehurinë; punë e fshehtë (thuhet sidomos për gjëjera që nuk kanë rëndësi); p. sh: I duallën' së fundi fshehurickat' në faqe.

Fragjuarë (i—): (përdoret' për tokën) i terurë nga ujërat' të shiutë; i tharë në mënyrë që të munt të punohet' për t'umbjellurë.

Gorgolinë si dhe Bokërinë edhe Krakurinë.

Gallaqis: kolloqisën; kollonjgisën; llokoqisën; fëlliqën (bënj) me baltë; p. sh: Ugallaqis me baltë, ubë kollomaqe i shuari (thonë gratë për ndonjë kalama që, tuke lozur' me shokë, ka qënë llaturiturë me baltë).

Gallaqisurë (i—): i përbalturë; i bërë trok me baltë; i llaturiturë funt e krye me baltë.

Gumëzimë: zhurmë; oshëtimë.

Gumëzinj: oshëtinj; bënj zhurmë; p. sh: Gumëzijën' malet nga këmboret' të bagëtijësë; Gumëzin shtëpija nga kalamanjëtë; Gumëzin lumi (përroji).

Gërnjëtar dhe Ngërnjëtar: grindavec; njeri i grindurë; i grindosurë.

Greshdijë (shum. greshdija dhe greshdije): lëmoshdëra (kllashina, mbeturina) bari o kashte që tepërojnë' ndëpër greshdet' të kafshëvetë; Greshdijat' u a shtrojnë' kafshëvetë.

Gërxfaninj dhe gërxfanisën; përtypënj dhe sjellënj e dredhënj në gojë copë mish që s' grihetë, që s' kapërxehet dotë, (Në greqishten, është: kritsanizo).

Gërshërëzë (sidomos në shum. gërshërëza): trerë të hollë që lidhin' brinjarët' të kulmitë.

Gojac : gojash; gojështrëmbërë; që i mbahet' goja; që i është marrurë goja' memec.

Gërdhushtë (sidomos në shum gërdhushta) : gëzhutë; gërzhutë; mbeturinat nga të shoshurit' të drithitë që u hidhen' pulavet', pëllumbavet' dhe shpezëvet' t' jerë.

Gërç dhe gërçhë : vënt gur; vënt gurishte; i thatë.

Gurgule : grumbullë; njëri mbi t' jetrinë; p. sh : Bagëttja qenë mbledhur' gurgulë.

Gomarazi : barazi; një për një (nga fuqija etj.); p. sh : Ranë gomarazi të dy.

Gollak : gjel ngollak; gjel zetrashë.

Goak : guhak; i humburë, i lënë.

Glofkë dhe gllopkë : gropa që hapin' vegjëlija mbi tokë për loja të ndryshëme me top (me dojkë; me zhokë; me domkë).

Gjumash : njeri që i pëlqen gjumi. që flen shumë (gjatë).

Gjataman : i gjatë nga shtati; gjato (— ja); gjato (— tua).

Gjëllinj : kullosënj (gjëmëtonj) andej' e këtejë fije bari të rrallë; kërkonj andej' e këtejë për ushqim; p. sh : Kali po gjëllin në kopshtëra

Hondijë : ondijë; të vajtur mbarë; p. sh : Gjëja e vjedhurë s' ka hondijë; Është gjë pa hondijë.

Hondisënj : ondisënj; venj mbarë; p. sh : Kjo pemë nuk' hondisënj në vëndin' t' ënë (— s' e don vëndi).

Hondisurë (i —) : i vajturë mbarë; p. sh : Ke parë kësij far' njeriu të pahondisurë ? Blet' e kobiturë, blet' e pahondisurë.

Haromeno : i harruarë; i mbeturë; harraq; harruq.

(Fjalë e ngjizurë nga : haronj (harronj) dhe meno = i mbeturë; po ndofta është në 'të edhe hijeja e fundjes' greqishte : — menos e nngjiturë fjalës' së shqipësë : harronj; shif edhe : humbameno).

Humbameno : i humburë; i shushaturë; i hutuarë.

(Shif dhe fjalën' : haromeno).

Hundac dhe hundaç (fem. hundaçkë) : i pa hundë; i me hundë të shtypurë.

Hopë : herë; radhë; p. sh : I doli mirë puna këtë hopë.

Hoshë : svarrë; p. sh : E hoqën' hoshë.

Jargavel : që i hikin' (që i kullojnë') jargëtë nga goja.

Kucubiq : njeri i shkurtërë nga shtati; shkurtabiq; shuplik; shkurto (— ja).

Katraullë : pështjellim; zhurmë; zallahijë; zallahahijë.

Kokëgdhë (— ri; kokëgdhënjë) : kokëtrashë.

Kokëmish : si : kokëgdhë.

Kokëmbërdhok :

Krakurinë : tokë e hollë, e varfër; bokërinë; gorgolinë.

Kobë : vjedhë; vjedhje; vjedhëlë; p. sh : S' ka hondij' ajo shtëpijë se e ka kobën' brënda.

Kobitem : më ngjan (më ndodhën') vjedhë; p. sh : Po u kobit bleta nuk' bën hondijë.

Kobiturë (i —) : i vjedhurë; që i ka ndodhurë vjedhëlë; p. sh : Shtëpij' e kobiturë.

Kallkan : akullë; ujë të ngrirë; p. sh : Sot ujët' është bërë kallkan; Ujëta na u bë kallkan brënda në katua.

Hejet' të akullit' që mvaren' nga pikat' të strehësë në kohë dimëri të rëndë; stalaktitë.

(vijon)

Me rastin e Krisht-Lindjeve Shoqëria "Naim Frashëri, e klasës së II^e të Shkollës s' onë do të çfaqë në Korçë dramën kombëtare "Skënderbeu". Drama në fjalë është çfaqur vitin që shkoi disa herë në Elbasan dhe Tiranë ku pati sukses.

Ndreqje gabimesh.

Fjala e parë e Vjershës "Penda dhe Parmenda," duhet të jetë **mue** dhe jo **mirë**.

Në faqen duhet thënë në **nji kohë** dhe **nji kohë**; po n' atë vend duhet **edukuës** dhe jo **edukuer**.

Merni numërin e parë të vitit të kaluar dhe krahasoeni me këtë, që qarkullon sot, për të shikuar ndryshimin.